# Lutjet ditore të muslimanit

﴿ أذكار المسلم اليومية ﴾

[ Shqip – Albanian – ألباني ]

**Përktheu:** Lulzim Susuri

**Rishikoi:** Driton Lekaj

2011 - 1432

islamhouse.com

# ﴿ أذكار المسلم اليومية ﴾

« باللغة الألبانية »

ترجمة: لولزيم سوسري

مراجعة: دريتون ليكاي

2011 - 1432

islamhouse.com

O Zot! Më mbro nga përtacia dhe mendjemadhësia. O Zot! Më mbro nga dënimi i zjarrit dhe dënimi i varrit".

Kurse në mbrëmje thotë:

"أَمْسَيْنَا وَأَمْسَى الْمُلْكُ لِلَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، ..."

"E arritëm mbrëmjen dhe e gjithë pasuria e sundimi i takon vetëm Allahut, falënderimi është vetëm për Të, …".

Lexohet një herë në mëngjes:

"اَللَّهُمَّ بِكَ أَصْبَحْنَا وَبِكَ أَمْسَيْنَا وَبِكَ نَحْيَا وَبِكَ نَمُوتُ وَإِلَيْكَ النُّشُورُ"

"O Zot, me urdhërin Tënd e mbërrimë sabahun dhe po me të edhe mbrëmjen. Me urdhërin Tënd ngjallemi dhe me atë vdesim, para Teje do të tubohemi".

Kurse në mbrëmje thotë:

"اَللَّهُمَّ بِكَ أَمْسَيْنَا وَبِكَ أَصْبَحْنَا وَبِكَ نَحْيَا وَبِكَ نَمُوتُ وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ"

"O Zot, me urdhërin Tënd e mbërrimë mbrëmjen dhe po me të edhe sabahun. Me urdhërin Tënd ngjallemi dhe me atë vdesim, tek Ti është kthimi".

Lexohet tre herë kur qëndron në një vend: (nuk e dëmton gjë derisa të largohet nga ai vend)

"أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللَّهِ التَّامَّاتِ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ"

"Kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut që të më ruajë nga e keqja e gjithçkaje që ka krijuar".



## LUTJET PAS NAMAZEVE FARZ. (të detyrueshme)

"O Allah, prej Teje kërkoj falje" *(tri herë)* "أَسْتَغْفِرُ اللهَ"

"اَللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلاَمُ، وَمِنْكَ السَّلاَمُ، تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلاَلِ وَالْإِكْــرَامِ، لاَ إِلَــهَ إِلاَّ اللهُ وَحْدَهُ لاَ شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، اَللَّهُمَّ لاَ مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ وَلاَ مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ وَلاَ يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ"

"O Allah: Ti je Shpëtuesi dhe prej Teje vjen shpëtimi. Ti je i Lartmadhëruari, Fisniku. Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut, i Vetmi, i Pashok. Atij i takon sundimi dhe për Të është falenderimi. Mbi çdo gjë Ai është i Gjithëfuqishëm. O Zot! Nuk ka kush e jep atë që Ti e ndalon dhe nuk ka kush e ndalon atë që Ti e jep. Nuk ka vlerë (te Ti) dobia e askujt, çdo dobi vjen vetëm prej Teje".

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ وَحْدَهُ لاَ شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَــدِيرٌ. لاَ حَوْلَ وَلاَ قُوَّةَ إِلاَّ بِاللَّه، لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللَّهُ، وَلاَ نَعْبُدُ إِلاَّ إِيَّاهُ، لَهُ النِّعْمَةُ وَلَهُ الْفَضْلُ وَلَهُ الثَّنَاءُ الْحَسَنُ، لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللَّهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ"

"Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut. Atij i takon sundimi dhe falenderimi. Mbi çdo gjë Ai është i Gjithëfuqishëm, nuk ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut. Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut. Askënd nuk adhurojmë përveç Atij. Begatia dhe mirësia janë prej Tij dhe Atij i takon falenderimi më i mirë. Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut, me sinqeritet Atij i besojmë dhe i nënshtrohemi edhe nëse mosbesimtarët e urrejnë këtë".



"I Lartmadhëruar është Allahu" *(33herë)* "سُبْحَانَ اللهِ"

"Falenderimi i takon vetëm Allahut" *(33herë)* "اَلْحَمْدُ لِلَّهِ"

"Allahu është më i Madhi" *(33herë)* "اَللهُ أَكْبَرُ"

Dhe e plotëson të njëqintën duke thënë:

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ وَحْدَهُ لاَ شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ"

"Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut, i Vetëm, i Pashok. Atij i takon sundimi dhe falenderimi, dhe mbi çdo gjë Ai është i Gjithëfuqishëm". (Kush e thotë pas çdo namazi i falen gjynahet edhe po të jenë sa shkuma e detit)

Lexohet Ajeti Kursijj (që u përmend në fillim):

﴿اَللَّهُ لاَ إِلَهَ إِلاَّ هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ...﴾ سورة البقرة ٢٥٥

*"Kush e thotë atë (ajetin Kursijj) pas çdo namazi (farz) nuk e pengon atë asgjë për të hyrë në xhennet vetëm se vdekja".*

Lexohen nga një herë pas farzeve të drekës, ikindisë dhe të jacisë dhe nga tri herë pas farzeve të sabahut dhe të akshamit:

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ...﴾ ﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ...﴾ ﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ...﴾

Pas mëngjesit dhe mbrëmjes dhjetë herë:

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ وَحْدَهُ لاَ شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ عَلَى كُــلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ"

"Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut, i Vetëm, i Pashok. Atij i takon sundimi dhe falënderimi, Ai jep jetë edhe vdekje dhe mbi çdo gjë Ai është i Gjithëfuqishëm".



بسم الله الرحمن الرحيم

Thotë Allahu:

﴿فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ وَاشْكُرُوا لِي وَلاَ تَكْفُرُونِ﴾ سورة البقرة ١٥٢

«Më përkujtoni Mua, unë ju përkujtoj ju, më falenderoni dhe mos më mohoni».

DHURATË

# LUTJET DITORE TË MUSLIMANIT



أذكار المسلم اليومية باللغة الألبانية

# LUTJET E MËNGJESIT DHE TË MBRËMJES

*(Ajeti Kursijj)* <u>Lexohet një herë: në mëngjes, në mbrëmje, para gjumit:</u> (dhe është i mbrojtur nga shejtani)

﴿اَللَّهُ لاَ إِلَهَ إِلاَّ هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لاَ تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلاَ نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَـا فِـي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلاَّ بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلاَ يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلاَّ بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلاَ يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ﴾ سورة البقرة ٢٥٥

«Allahu është Ai që s`ka të adhuruar me meritë përveç Tij, i Përjetshmi, Mbajtësi dhe Mbrojtësi (i gjithçkaje që ekziston). As kotje e as gjumë nuk e kap Atë. Atij i përkasin gjithë ç`është në qiej e gjithë ç`është në tokë. E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai përveç se me lejen e Tij? Ai di se çfarë u ndodh krijesave të Tij në këtë botë, dhe çfarë do t`u ndodhë atyre në botën tjetër, dhe ata nuk dinë ndonjë gjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do. Kursijja e Tij përfshin qiejt dhe tokën dhe Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajten dhe mbrojtjen e tyre. Dhe Ai është më i Larti, më Madhështori».

<u>Lexohen nga tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u>

بسم الله الرحمن الرحيم

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ(١) اللَّهُ الصَّمَدُ(٢) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ(٣) وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ(٤)﴾

Thuaj (O Muhamed a.s): "Ai është Allahu, Një dhe i vetëm. Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe s'ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me të".



بسم الله الرحمن الرحيم

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ(١) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ(٢) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ(٣) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ(٤) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ(٥)﴾

Thuaj: "I mbështetem (Allahut) Zotit te agimit (të më ruajë). Nga sherri (e keqja) i asaj që ka krijuar, dhe nga sherri i errësirës (së natës) kur ajo vjen me errësirën e saj, dhe nga sherri i atyre që bëjnë magji kur u fryejnë nyjeve, dhe nga sherri i ziliqarit kur me zili vepron".

بسم الله الرحمن الرحيم

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ(١) مَلِكِ النَّاسِ(٢) إِلَهِ النَّاسِ(٣) مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ(٤) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ(٥) مِنْ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ(٦)﴾

Thuaj: "I mbështetem (Allahut) Zotit të njerëzve, Mbisunduesit të njerëzve, të adhuruarit të njerëzve, nga sherri (e keqja) e vesvesit pëshpëritës që tërhiqet, (që largohet pas futjes së vesveseve) i cili pëshpërit në gjokset e njerëzve, (qoftë pëshpëritësi) nga xhindët dhe nga njerëzit".

<u>Lexohet një herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u> (Kush e thotë këtë dua në mëngjes i bindur në atë që thotë dhe vdes në atë ditë, hyn në xhenet po kështu kush e thotë në mbrëmje)

"اَللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لاَ إِلَهَ إِلاَّ أَنْتَ خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ وَأَبُوءُ لَكَ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّـهُ لاَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلاَّ أَنْتَ"

"O Allah! Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër me meritë



përveç Teje. Unë jam robi Yt, do t` i qëndroj besnik besës dhe premtimit Tënd sa të mundem. Kërkoj mbrojtjen tënde prej të keqes që kam bërë. Të jam mirënjohës ndaj begative të Tua dhe i pranoj gjynahet e mia. Mi fal gjynahet se s`ka tjetër që i fal ato përveç Teje!".

<u>Lexohet një herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u>

"اَللَّهُمَّ عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ فَاطِرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ، رَبَّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكَهُ، أَشْهَدُ أَنْ لاَّ إِلَهَ إِلاَّ أَنْتَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي، وَمِنْ شَرِّ الشَّيْطَانِ وَشِرْكِهِ، وَأَنْ أَقْتَـرِفَ عَلَى نَفْسِي سُوءًا، أَوْ أَجُرَّهُ إِلَى مُسْلِمٍ"

"O Zot! Ti je i Gjithëdituri i çdo të fshehteje dhe i çdo të dukshmeje, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, dhe Zoti e Mbizotëruesi i çdo gjëje. Dëshmoj se s`ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Teje. Kërkoj që të më mbrosh nga e keqja e vetes sime dhe nga e keqja e djallit dhe nga ajo që ai të shpie në shirk. Më mbro që vetes time mos t`i bëj të keqe e as ndonjë muslimani".

<u>Lexohen nga tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u>

"رَضِيتُ بِاللهِ رَباً، وَبِالإِسْلاَمِ دِيناً، وَبِمُحَمَّدٍ ﷺ نَبِياً"

"Jam i kënaqur që Zoti im është Allahu,feja ime është islami dhe Profeti im është Muhammedi (alejhi salatu ue selam)".

<u>Lexohen nga tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u>

"بِسْمِ اللَّهِ الَّذِي لاَ يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلاَ فِي السَّمَاءِ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ"

"Lus Allahun me emrin e Tij, i cili nuk të dëmton me të asnjë (e keqe) në qiell dhe në tokë dhe Allahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri".



<u>Lexohet një herë në mëngjes dhe në mbrëmje:</u>

"اَللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ، اَللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِـي دِينِي وَدُنْيَايَ، وَأَهْلِي وَمَالِي، اَللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَاتِي، وَآمِنْ رَوْعَاتِي، اَللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَـيْنِ يَدَيَّ وَمِنْ خَلْفِي وَعَنْ يَمِينِي وَعَنْ شِمَالِي وَمِنْ فَوْقِي وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي"

"O Zot! Prej Teje kërkoj falje dhe shpëtim në këtë botë dhe në tjetrën. O Zot! Prej Teje kërkoj falje dhe shpëtim (për çdo gjë që ngjet) në fenë time, në jetën time, në familjen time dhe në pasurinë time. O Zot! Na i mbulo punët (veprat) e turpshme dhe na ruaj nga momentet e frikës dhe të trishtimit (Ditën e Kijametit). O Zot! Na ruaj nga përpara dhe nga pas, nga e djathta dhe nga e majta, dhe nga sipër si dhe të mbështetemi Ty nga të përpirit (e tokes) nga poshtë".

<u>Lexohet një herë në mëngjes:</u>

"أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمُلْكُ لِلَّهِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ، لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللَّهُ وَحْدَهُ لاَ شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، رَبِّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهُ وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ، وَسُـوءِ الْكِبَرِ، رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابٍ فِي النَّارِ وَعَذَابٍ فِي الْقَبْرِ"

"E arritëm mëngjesin dhe e gjithë pasuria e sundimi i takon vetëm Allahut, falenderimi është vetëm për Të, s`ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Tij. Atij i takon sundimi dhe falenderimi dhe Ai mbi çdo gjë është i Gjithëfuqishëm. O Zot! Të lus Ty të mirën e kësaj dite dhe të mirën që sjell dita tjetër. O Zot! Më mbro nga e keqja e kësaj dite dhe nga e keqja që sjell dita tjetër.